



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:009224
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05635405

C.nr.306/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Ibrahim Maloku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit D.R nga Zveçani, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit M,M, avokate nga Graçanica, kundër të paditurës KEDS – Drejtori i Divizionit të Furnizimit të Distriktit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimin e vendimit, konstatimin se paditësi ka statusin e punëtorit për një kohë të pacaktuar, si dhe kthimin në vendin e punës me gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 900.00 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me dt.29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË E PALEJUESHME padia e paditësit D.R, e cila evidentohet nën shenjën C.nr.306/23, e parashtruar me datë 12.01.2023, kundër të paditurës KEDS – Drejtori i Divizionit të Furnizimit të Distriktit, me seli në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit, konstatimin se paditësi ka statusin e punëtorit për një kohë të pacaktuar, si dhe kthimin në vendin e punës me gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

Paditësi D.A nga Zevçani, përmes përfaqësueses së autorizuar, M.M, avokate me seli në Graçanicë, pranë kësaj Gjykate me dt.12.01.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës KEDS – Drejtori i Divizionit të Furnizimit të Distriktit, me seli në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit, konstatimin se paditësi ka statusin e punëtorit për një kohë të pacaktuar, si dhe kthimin në vendin e punës. Në referatin e padisë ndër të tjera pretendohet se paditësi me të paditurën kontratën e parë e kanë lidhur me datën 08.05.2014, dhe kështu vazhdimisht e ka vazhduar kontratën për një periudhë të caktuar kohore, ku kontrata e fundit është lidhur me datën 04.02.2021, për pozitën koordinator për projekte të veçanta. Kanë theksuar se kontrata në fjalë është zbatuar plotësisht sipas të gjitha pikave të cekura e në përputhje me Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës nr.03/L-212. Ka shtuar se sipas nenit 10 par.9 të Ligjit në fjalë se në rastet kur me të punësuarin lidhet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me ligjin në fjalë dhe nëse në një kohë të vazhdueshme të pandërprerë, kontrata automatikisht kalon në punësim të përhershëm. Tutje ka shtuar se nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka punuar në punë dhe detyrat që i ka kryer kanë karakter të përhershëm, madje nuk ka

patur as kundërshtime në punën e tij, andaj, nuk ka patur arsye të justifikueshme për suspendimin dhe ndërprerjen e njëanshme të Kontraës, e posaqërsisht se nuk ka patur procedurë disiplinore gjatë marrëdhënies së punës. Tutje ka shtuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të njëanshme, për të cilën paditësi nuk ka qenë i informuar, më saktë nuk ka marrë asnjë vendim, nuk është ftuar që të deklaroj për çfarëdo deklarate lidhur me çka, se cilat ishin arsyet për ndërprerjen, por ka marrë vesh nga radhët e kolegëve të tij, nuk ka nënshkruar e as nuk është pajtuar për asgjë, nuk ka qenë në dijeni, gjë që këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin e Punës. Nga këto arsye ka kërkuar anulimin anulimin e vendimit nr.12527, dt.30.12.2022, konstatimin se paditësi ka statusin e punëtorit për një kohë të pacaktuar, si dhe kthimin në vendin e punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se padia e paditësit Dejan Radojevic, duhet të hedhet si e palejueshme.

Gjykata fiillimisht sjellë në vëmendje se në kontest nga marrëdhënia e punës, është e domosdoshme që në çdo fazë të procedurës të përqendrohet në vlerësimin e faktit nëse janë përmbushur dy parakushte apo prezumime bazë: 1) që i punësuar – paditësi, para se të kërkojë realizimin e të drejtës së pretenduar në rrugë gjyqësore, paraprakisht i ka shfrytëzuar procedurat interne pranë punëdhënësit dhe 2) nëse padia është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Prezumimet në fjalë duhet përmbushur në mënyrë kumulative, në mënyrë që të ofrohet mbrojtje gjyqësore lidhur me të drejtat e pretenduara që burojnë nga marrëdhënia e punës.

Në funksion të këtij vlerësimi, referuar natyrës dhe periudhës kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, Gjykata iu referua Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.01.11.2010, ligj i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë nga dita e publikimit. Dispozita nga neni 2 e këtij ligji, e cila i referohet fushës së zbatimit, në paragrafin 1 përcakton që: "*Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës*". Dispozita nga neni 78 e këtij ligji parasheh: "*1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 79 e po këtij ligji, parasheh që: "*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente*". Qëllimi i dispozitave të lartëcekura ka të bëjë me inkurajimin e arritjes së një zgjidhje përmes konsumit të procedurave interne, duke i dhënë një lloj përparësie një procedure të tillë karshi mbrojtjes gjyqësore, e cila duhet të vijë në shprehje si alternativë e fundit.

Në rastin konkret, nga thëniet e paditësit në padi, e në ndërlidhje me provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se veprimi i të paditurës, me të cilin pretendohet që paditësit i janë shkelur të drejtat nga marrdhënia e punës, është materializuar përmes vendimit mbi mos vazhdimin e kontratës së punës nr.12527, të datës 30.12.2022, akt ky të cilin pala paditëse e ka kontestuar në padi, duke e kërkuar edhe anulimin e të njëjtit në petitum të kërkesëpadiisë.

Pas pranimit të këtij vendimi, në bazë të provave materiale të cilat gjenden në dispozicion në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se paditësi nuk ka paraqitur fare kërkesë tek pala e paditur lidhur me shkeljen e pretenduar, duke mos e konsumuar në këtë mënyrë të drejtën e garantuar me dispozitën e lartëcekur nga neni 78 të Ligjit të Punës, e cila i referohet shfrytëzimit të mjeteve interne pranë punëdhënësit. Madje vendimi i atakuar me këtë padi e ka edhe udhëzimin juridik se kundër të njëjtit mund të paraqesë ankesë në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit tek organi kompetent i punëdhënësi. Përkundër kësaj paditësi ka paraqitur drejtpërdrejtë padi në gjykatë me dt.12.01.2023. Si pasojë e një lëshimi të tillë, meqenëse nuk përmbushet parakushti i parë, Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e faktit nëse ka ardhur në shprehje edhe plotësimi i parakushtit të dytë, që ka të bëjë me parashtrimin e padisë brenda afatit të përcaktuar me dispozitën nga neni 79 të Ligjit të Punës.

Bazuar në këto rrethana, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se padia e ushtruar në këtë çështje juridike rezulton të jetë e parakohshme, që rrjedhimisht nënkupton se paditësi nuk e ka fituar të drejtën që të kërkojë realizimin e të drejtës së pretenduar nga marrdhënia e punës përmes rrugëve gjyqësore.

Ky vlerësim i Gjykatës gjen mbështetje edhe në qëndrimet e shprehura nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Përmbledhjes nga Praktika e Gjykatës Supreme në Çështje Penale dhe Civile, Prishtinë, 2023, gjegjësisht në kapitullin VII - Kontestet e punës, shqyrtimi paraprak i padisë, afati për paraqitjen/lejueshmërinë e padisë si prezumim procedural. Gjegjësisht në faqen 501 të kësaj përmbledhje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, shprehimisht potencon: *“Pra, i punësuari nuk mund ta kërkojë mbrojtje gjyqësore sa i përket të drejtave nga marrdhënia e punës, pa i shterur paraprakisht procedurat interne (mjetet e brendshme).”*.

Si përfundim, në një situatë të tillë, Gjykata nuk ka tagër që të procedojë me vlerësimin e pretendimeve që kanë të bëjnë me themelësinë e kërkesëpadiisë, pasi në këtë fazë të procedurës, padia duhet hedhur poshtë si e palejueshme, në kuptim të dispozitës së nenit 391 pika f) e LPK-së, e cila përcakton: *"Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj"*.

Gjykata mori parasysh faktin se dispozita e lartëcekur i referohet situatave kur padia paraqitet pas skadimit të afatit, e në këtë kuptim vlerëson se ekziston hapësirë që kjo dispozitë të aplikohet edhe në rastin konkret, për faktin se kemi të bëjmë me kontest të natyrës së tillë për të cilin afatet dhe parakushtet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore parashikohen me dispozitat e

një ligji të veçantë, respektivisht me Ligjin e Punës. Për më tepër, dispozitat nga nenet 78 dhe 79 të këtij ligji duhet të interpretohen në lidhshmëri me njëra - tjetrën në aspektin e vlerësimit të afatshmërisë së paraqitjes së padisë.

Bazuar në këto arsye, e në kuptim të dispozitave të lartcekura, Gjykata vendosi decidivisht si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në atë mënyrë që është hedhur poshtë si e palejueshme padia e paditësit D.Anga Prishtina, e cila evidentohet nën shenjën C.nr.306/23, e parashtruar me datë 12.01.2023, kundër të paditurës KEDS – Drejtori i Divizionit të Furnizimit të Distriktit, me seli në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit, konstatimin se paditësi ka statusin e punëtorit për një kohë të pacaktuar, si dhe kthimin në vendin e punës me gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 450 të LPK-së.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
C.nr.306/23, datë 29.04.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.